



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-112/02-2042523/24

dt. 26.06.2024

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe nenin 24 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për emërimin e Zyrtar/es Përgjegjës për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik)

1. Emërohet znj. Blerina Kastrati Idrizi, Zyrtare Përgjegjëse për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik për Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Zyrtar-ja e emëruar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi është e obliguar që të bëjë përgatitjen e formularëve shpjegues të projekt-propozimit për konsultim publik dhe dokumentacionit përcjellës, koordinimin e konsultimit publik në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e Draftit fillestar të Projekt-Propozimit dhe Grupin Punues, përcjelljen e afateve kohore për procesin e Konsultimit Publik, dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tjera konform dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë.
3. Zyrtar-ja përgjegjëse obligohet që të përgatisë Raporte Vjetore për procesin e Konsultimit Publik në Komunë, dhe për të njëjtat raporton tek Kryetari i Komunës dhe në Njësinë Përgjegjëse për Monitorim të Komunave në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Në rast të mungesës së Zyrtar-es së emëruar për koordinimin e procesit të Konsultimit Publik, kompetente është Zyra për Informim.

5. Mandati i Zyrtares së emëruar është 1 (një) vjeçar me mundësi vazhdimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës



Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 E-mail i Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Komunës i datës 25.06.2024

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 znj. Blerina Kastrati Idrizi
- 1x1 Arkivit

